RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI AUDITIMIN E SISTEMEVE TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË QENDRËN E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE BUJQËSORE FUSHË-KRUJË



Tiranë, shtator 2026

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3**
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	**3**
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	**4**
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	**5**
II	**HYRJA**	**5**
1.	Objektivat dhe qëllimi	**5**
2.	Identifikimi i çështjeve	**6**
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	**6**
4.	Përgjegjësitë e audituesve	**6**
5.	Kriteret e vlerësimit	**6**
6.	Standardet e auditimit	**7**
7.	Metodat e auditimit	**7**
8.	Dokumentimi i auditimit	**7**
I!I.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**7**
1.	**Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim**	**7**
2.	**Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**	**8**
2.1.	Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit	**8-12**
2.2	Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.	**12-16**
IV.	**REKOMANDIME**	**17**

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", datë 27.11.2014, zhvilloi një auditim të Teknologjisë së Informacionit në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë (QTTB) nga data 10.06.2026 deri më datë 08.07.2026.
Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.
Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

a. Përshkrim i shkurtër i Institucionit

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë është institucion publik në varësi të Ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, me mision mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe zonave rurale në Republikën e Shqipërisë, përmes gjenerimit, përshtatjes, testimit dhe transferimit të teknologjive bashkëkohore bujqësore.Në përmbushje të këtij misioni, Qendra kontribuon në rritjen e produktivitetit, cilësisë dhe konkurrueshmërisë së prodhimit bujqësor e blegtoral, duke promovuar inovacionin, përdorimin efikas të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, ajo ofron ekspertizë teknike, shërbime analitike, trajnime dhe informacion për fermerët, strukturat e këshillimit bujqësor, agrobizneset dhe institucionet e sektorit, si dhe shërbime të specializuara në fushën e tokës dhe ujërave, në mbështetje të politikave kombëtare për zhvillimin e bujqësisë dhe garantimin e sigurisë ushqimore.

b. Rëndësia e Institucionit dhe e auditimit të tij

QTTB Fushë-Krujë luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e politikave kombëtare për zhvillimin e sektorit bujqësor, nëpërmjet transferimit të njohurive, teknologjive dhe praktikave bashkëkohore tek përfituesit e shërbimeve të saj. Për realizimin e këtij misioni, institucioni mbështetet në përdorimin e sistemeve dhe infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit për administrimin e informacionit, ofrimin e shërbimeve dhe mbështetjen e proceseve të punës. Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit është i rëndësishëm për shkak të rritjes së varësisë së institucioneve nga teknologjia dhe nevojës për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit. Menaxhimi joefektiv i sistemeve të informacionit mund të ndikojë në vazhdimësinë e shërbimeve, mbrojtjen e të dhënave dhe realizimin e objektivave institucionale. Përzgjedhja e këtij subjekti për auditim është bazuar në analizën e riskut të kryer gjatë hartimit të Planit Vjetor të Auditimit dhe Programit të Auditimit, ku është vlerësuar e nevojshme kryerja e auditimit të sistemeve të Teknologjisë së Informacionit për të vlerësuar efektivitetin e qeverisjes së TI-së dhe të kontrolleve të vendosura për mbrojtjen e informacionit.

c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe objektivat

Qëllimi i auditimit është vlerësimi i kuadrit të qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit në QTTB Fushë-Krujë, me synim evidentimin e nivelit të organizimit, menaxhimit dhe kontrollit të burimeve të TI-së, si dhe përcaktimin nëse strukturat, politikat dhe procedurat e institucionit mbështesin përdorimin efektiv, të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemeve të informacionit. Auditimi është kryer për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025, duke u fokusuar në drejtimin "Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit" dhe Siguria e të dhënave.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave

Auditimi është realizuar në përputhje me standardet e auditimit të KLSH-së dhe Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, duke përdorur metodologjinë e auditimit të bazuar në risk. Kjo metodologji synon përqendrimin e procedurave audituese në proceset dhe kontrollet që paraqesin nivelin më të lartë të riskut, duke siguruar përdorimin efektiv dhe eficient të burimeve të auditimit.
Në përcaktimin e natyrës, kohës dhe shtrirjes së procedurave të auditimit janë marrë në konsideratë rëndësia e proceseve të Teknologjisë së Informacionit, niveli i ekspozimit ndaj risqeve dhe ndikimi i tyre në funksionimin e institucionit.
Bazuar në punën në terren, grupi i auditimit vlerësoi se evidencat e mbledhura ishin të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme për të mbështetur konkluzionet e auditimit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 624/1, datë 10.06.2026.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në raportin e auditimit janë formuluar 14 gjetje dhe 14 rekomandime për masa organizative.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore

- Nga auditimi u konstatua se Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë nuk ka në strukturën organizative specialist të Teknologjisë së Informacionit, megjithëse administron infrastrukturë IT, rrjet kompjuterik, faqen zyrtare të internetit dhe sistemin WebGIS. Për shkak të mungesës së një strukture ose specialisti të dedikuar të TI-së, institucioni nuk disponon kapacitetet e nevojshme profesionale për administrimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke u mbështetur kryesisht në njohuritë bazë të punonjësve për menaxhimin e aseteve TIK. Kjo situatë rrit rrezikun e gabimeve njerëzore, konfigurimeve të pasakta, vonesave në trajtimin e incidenteve dhe cenon sigurinë, integritetin, disponueshmërinë dhe funksionimin efektiv të sistemeve të informacionit. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 15 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, i cili kërkon sigurimin e burimeve të nevojshme për funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm, si dhe me standardin ISO/IEC 27001:2022, pika 5.3 "Organizational roles, responsibilities and authorities", që kërkon përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive për sigurinë e informacionit.
- Nga auditimi u konstatua se procesi i përditësimit dhe administrimit periodik të të dhënave në sistemin WebGIS nuk realizohet, pasi deri në momentin e auditimit ishin plotësuar me të dhëna vetëm 8 nga 61 bashki. Mungesa e një procesi të strukturuar për mbledhjen, verifikimin dhe përditësimin e informacionit ndikon në plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të administruara nga sistemi, duke kufizuar përdorimin efektiv të tij për qëllimet institucionale, në mospërputhje me kërkesat e standardit ISSAI 5310.
- Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni teknik i ArcGIS Server SDK është i aksesueshëm publikisht nga interneti dhe i indeksuar nga motorët e kërkimit pa autentikim, duke lehtësuar identifikimin e teknologjive të përdorura dhe rritur ekspozimin ndaj sulmeve. Kjo situatë nuk është në përputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, kontrolli 8.2.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore.

- Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrë masa për sigurimin e kapaciteteve profesionale të nevojshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit, nëpërmjet plotësimit të strukturës me specialist të TI-së, me qëllim garantimin

e administrimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit efektiv të infrastrukturës IT dhe sistemit WebGIS.
- QTTB Fushë-Krujë të marrë masa për përditësimin periodik dhe të plotë të të dhënave në sistemin WebGIS, duke përcaktuar përgjegjësitë e strukturave përkatëse dhe duke siguruar popullimin e sistemit me të dhëna për të gjitha bashkitë.
- QTTB Fushë-Krujë të kufizojë aksesin publik në komponentët teknikë të ArcGIS Server SDK dhe të konfigurojë sistemin në mënyrë që dokumentacioni dhe shërbimet administrative të mos jenë të aksesueshme nga interneti, përveç rasteve kur kjo është e domosdoshme.

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit:

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", nga auditimi u konstatua se qeverisja e Teknologjisë së Informacionit dhe administrimi i sistemit WebGIS në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë nuk janë në përputhje të plotë me praktikat e mira të menaxhimit të TI së dhe sigurisë së informacionit. U evidentuan mangësi në qeverisjen e TI së, të lidhura me mungesën e dokumentacionit rregullator, menaxhimin e riskut, mirëmbajtjen e sistemit dhe kapacitetet njerëzore për administrimin e tij.
Në aspektin funksional, sistemi WebGIS nuk shfrytëzohet në potencialin e tij, pasi pas përfundimit të kontratës së mirëmbajtjes nuk janë kryer përditësime të rregullta të të dhënave dhe informacioni është populluar vetëm për 8 nga 61 bashki. Auditimi evidentoi mangësi në sigurinë fizike dhe logjike të infrastrukturës IT, përfshirë administrimin e aseteve, kushtet e dhomës së serverëve, përdorimin e një versioni të vjetëruar të platformës ArcGIS Enterprise dhe ekspozimin e komponentëve teknikë të sistemit në internet.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH*", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 624/1, datë 10.06.2026, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 10.06.2026 deri në 08.07.2026, në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë, (më poshtë QTTB), ku periudha e audituar është 01.01.2025 deri në 31.12.2025, u krye auditimi me objekt "*Auditimi i Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit*", nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. A.A, anëtar
3. M B, anëtar

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i auditimit është vlerësimi i përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të teknologjisë së informacionit nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë, me fokus tek ekzistenca dhe efektiviteti i kontrolleve kryesore për mbrojtjen e të dhënave. Auditimi ka pasur për qëllim të përcaktojë nëse praktikat e ndjekura janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të QTTB dhe standarded e sigurisë së informacionit, si dhe nëse sigurohet konfidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit. Qëllimi i auditimit të kryer në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë është të ofrojë një vlerësim të pavarur mbi gjendjen aktuale të kontrolleve të teknologjisë së informacionit, në raport me menaxhimin, sigurinë, mirëmbajtjen dhe përdorimin e infrastrukturës ekzistuese. Auditimi synon të identifikojë dobësitë dhe proceset teknologjike, të vlerësojë rreziqet e mundshme. Për realizimin e këtij qëllimi, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna, dokumente, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310.

II.2 Identifikimi i çështjeve

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr. 624/1, datë 10.06.2026.
1.Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit
2.Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë ka për mision të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të zonave rurale në Shqipëri, nëpërmjet gjenerimit, përshtatjes, testimit, demonstrimit dhe transferimit të teknologjive bashkëkohore bujqësore. Nëpërmjet veprimtarisë së saj, qendra synon të rrisë produktivitetin, cilësinë dhe konkurrueshmërinë e prodhimit bujqësor e blegtoral, duke nxitur inovacionin, përdorimin e qëndrueshëm dhe efikas të burimeve natyrore, si dhe mbrojtjen e mjedisit.
Për realizimin e këtij misioni, Qendra ofron ekspertizë teknike dhe shkencore, shërbime analitike laboratorike, trajnime profesionale, demonstrime teknologjike dhe informacion të specializuar për fermerët, strukturat e këshillimit bujqësor, agrobizneset dhe institucionet e sektorit. Gjithashtu, ajo siguron shërbime të specializuara në fushën e tokës dhe ujërave, duke mbështetur hartimin dhe zbatimin e politikave kombëtare për zhvillimin e bujqësisë, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe garantimin e sigurisë ushqimore.

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2025 deri në 31.12.2025, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.
Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 624/1, datë 10.06.2026, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjislacionin e fushës në të cilën operon Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë Raport Përfundimtar krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.
Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:
- Standarded Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT, ISO/IEC 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);

- Ligji nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimit e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";
- Ligji Nr. 43/2023 "*Per Qeverisjen Elektronike*";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Ligji nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*".
- VKM nr. 782, datë 18.12.2024, "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike*".
- VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit*", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar;
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 19.07.2006, "*Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", i ndryshuar;*
- -Udhëzimi nr. 21, datë 25.10.2016, "*Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve*";
- Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, "*Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike*";
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testime dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310.

II.7 Metodat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi.

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë (QTTB Fushë Krujë) është institucion publik në varësi të ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, i krijuar dhe që ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, në veçanti me Vendimin e Këshillit të

Ministrave nr. 515, datë 19.07.2006**,** "Për ristrukturimin e instituteve kërkimore-shkencore në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", i ndryshuar.
Misioni i Qendrës është të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe të zonave rurale në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet kërkimit të aplikuar, gjenerimit, testimit, përshtatjes, demonstrimit dhe transferimit të teknologjive bashkëkohore bujqësore. Nëpërmjet veprimtarisë së saj, Qendra synon të rrisë produktivitetin, cilësinë dhe konkurrueshmërinë e prodhimit bujqësor e blegtoral, të nxisë inovacionin, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit dhe forcimin e sigurisë ushqimore.
Për përmbushjen e këtij misioni, Qendra zhvillon kërkime të aplikuara, eksperimente dhe testime në stacionet eksperimentale dhe në fermat bashkëpunuese; identifikon, teston, përshtat, demonstron dhe transferon teknologji, metoda dhe inpute inovative të përshtatshme për kushtet agro-ekologjike të vendit; harton dhe promovon paketa teknologjike për kulturat bujqësore dhe mbarështimin e kafshëve; prodhon dhe shumëzon materiale biologjike të certifikuara; ofron analiza laboratorike, ekspertizë teknike e shkencore dhe shërbime këshillimore për fermerët dhe institucionet e sektorit; organizon trajnime, demonstrime dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve profesionale; harton dhe publikon materiale teknike e shkencore; bashkëpunon me institucione kërkimore, universitete dhe organizata vendase e ndërkombëtare për zhvillimin e projekteve dhe inovacionit në bujqësi; si dhe mbështet ministrinë përgjegjëse për bujqësinë dhe institucionet e tjera publike me studime, analiza dhe ekspertizë për hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural dhe sigurisë ushqimore.
Qendra ushtron edhe çdo funksion tjetër që i ngarkohet nga legjislacioni në fuqi dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit


2.1 Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 "*Auditimi i Qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit*" të Programit të Auditimit nr. 624/1, datë 10.06.2026 u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Organigrama dhe struktura organizative e institucionit;
- Regjistër risku si dhe planet e menaxhimit të tij për periudhën e audituar;
- Pyetësorë dhe intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Përshkrim i përgjithshëm i teknologjisë së informacionit në QTTB;
- Etj.

Qeverisja e Teknologjisë së Informacionit përbën një element thelbësor për funksionimin efektiv të çdo institucioni, duke siguruar që burimet dhe shërbimet e TI-së të administrohen në përputhje me objektivat institucionale, kërkesat ligjore dhe parimet e kontrollit të brendshëm. Një strukturë organizative e qartë, me role dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara, është parakusht për administrimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemeve të informacionit.
Në kuadër të auditimit u vlerësuan elementët e qeverisjes së TI-së në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë, duke përfshirë strukturën organizative, administrimin e sistemit WebGIS, procedurat e brendshme, dokumentacionin mbi mirëmbajtjen e sistemit, trajnimin e stafit, menaxhimin e riskut, si dhe dokumentacionin që lidhet me përdorimin e sistemit. Nga verifikimi rezultoi se, me Urdhrin Nr. 134, datë 30.07.2024, është miratuar struktura dhe organika e QTTB Fushë-Krujë, e cila parashikon 61 pozicione pune. Megjithatë, në momentin e auditimit, 13 prej këtyre pozicioneve rezultonin vakante, duke kufizuar kapacitetet administrative dhe operacionale të institucionit. Mungesa e burimeve njerëzore mund të ndikojë në ushtrimin efektiv të funksioneve të institucionit, përfshirë administrimin, monitorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit, si dhe në zbatimin e mekanizmave të kontrollit të nevojshëm për një qeverisje efektive të TI-së.

Organograma e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë Krujë



Burimi: QTTB Fushë-Krujë

Nga auditimi u konstatua se Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë nuk ka në strukturën organizative specialist të Teknologjisë së Informacionit, megjithëse administron infrastrukturë IT, rrjet kompjuterik, faqen zyrtare të internetit dhe sistemin WebGIS. Mungesa e një specialisti të dedikuar IT krijon varësi nga personel që nuk ka funksion të posaçëm për administrimin e teknologjisë së informacionit dhe rrit rrezikun që proceset e administrimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit të sistemeve të mos kryhen në mënyrë të vazhdueshme dhe sipas praktikave të mira.

Trajnimet

Zhvillimi i trajnimeve ka një rëndësi të veçantë për menaxhimin e kapaciteteve njerëzore në institucion. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e stafit për trajnime mbi teknologjinë e informacionit. Punonjësit të cilët kanë akses në sistemet e informacionit duhet të jenë të njohur me standardet e sigurisë dhe të gëzojnë aftësinë për zbatimin dhe implementimin e tyre gjatë aktivitetit që kryejnë.
Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka hartuar një plan trajnimi për përdoruesit dhe administratorët e sistemit WebGIS dhe nuk u administruan evidenca që të provojnë zhvillimin e trajnimeve për përdorimin dhe administrimin e sistemit pas implementimit të tij. Si rrjedhojë, nuk garantohet që personeli disponon njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për administrimin dhe përdorimin efektiv të platformës.

Politikat aktet rregullatorë të standardeve në TIK

Në kuadër të vlerësimit të qeverisjes së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), grupi i auditimit analizoi ekzistencën, plotësinë dhe zbatimin e politikave, rregulloreve të brendshme, procedurave operative dhe akteve administrative që rregullojnë administrimin, përdorimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve informatike të institucionit. Gjithashtu, u vlerësua nëse këto dokumente janë të përditësuara, të miratuara nga autoritetet përgjegjëse dhe të zbatueshme në praktikë.
Një kuadër i plotë dhe i mirëstrukturuar rregullator përbën bazën e një qeverisjeje efektive të Teknologjisë së Informacionit, pasi siguron përcaktimin e qartë të roleve dhe përgjegjësive të personelit, standardizimin e proceseve të administrimit dhe operimit të sistemeve, si dhe vendosjen e mekanizmave të kontrollit për monitorimin dhe mbikëqyrjen e tyre. Njëkohësisht, ai kontribuon në garantimin e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit, minimizimin e risqeve që lidhen me përdorimin e sistemeve informatike, respektimin e kërkesave ligjore dhe rregullatore, si dhe sigurimin e vazhdimësisë së funksionimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit. Mungesa ose pamjaftueshmëria e këtij kuadri rrit ekspozimin e institucionit ndaj risqeve operacionale dhe të sigurisë, duke

dobësuar efektivitetin e kontrolleve të brendshme dhe administrimin e sistemeve të informacionit.
Gjatë auditimit u konstatua se administrimi i sistemit WebGIS kryhet nga një specialist i institucionit, pa një akt administrativ që të përcaktojë emërimin, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e administratorit të sistemit. Po ashtu, institucioni nuk ka hartuar dhe miratuar një rregullore ose procedura të dokumentuara për administrimin e sistemit WebGIS, në të cilat të përcaktohen mënyra e administrimit të përdoruesve, kontrolli i aksesit, mirëmbajtja, monitorimi dhe përgjegjësitë e personave që administrojnë sistemin. Mungesa e këtij dokumentacioni bën që administrimi i sistemit të mbështetet kryesisht në praktikën individuale të punonjësve dhe jo në procedura të standardizuara dhe të miratuara nga institucioni.

Marrëveshja e Nivelit të Shërbimit (MNSH)

Për mbështetjen e veprimtarisë së punonjësve të Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë është krijuar sistemi i centralizuar WebGIS, me qëllim administrimin, ruajtjen dhe përpunimin e informacionit gjeohapësinor, si dhe të dhënave të tjera që lidhen me tokën bujqësore.
Në zbatim të VKM nr.710, datë 21.08.2013, "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdimësisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) zhvilloi procedurën e prokurimit dhe lidhi kontratën për zhvillimin e sistemit ndërmjet palëve. Kontrata hyri në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët në datën 28.12.2022.
Sipas kushteve të kontratës, periudha e implementimit të sistemit ishte 6 muaj nga data e hyrjes në fuqi të saj. Pas përfundimit të implementimit dhe marrjes në dorëzim të sistemit nga autoriteti kontraktor, filloi periudha e mirëmbajtjes dhe suportit teknik, me kohëzgjatje 24 muaj.
Kontrata përfundoi efektet e saj në muajin Qershor 2025. Me përfundimin e periudhës së garancisë dhe mirëmbajtjes, operatori ekonomik u lirua nga detyrimet kontraktore për ofrimin e mbështetjes teknike, mirëmbajtjes dhe eliminimin e defekteve të sistemit. Si rrjedhojë, pas kësaj periudhe sistemi WebGIS mbeti pa kontratë mirëmbajtjeje dhe pa mbështetje teknike nga operatori ekonomik.
Nga auditimi u konstatua se kontrata për mirëmbajtjen e sistemit WebGIS ka përfunduar dhe nuk është rinovuar. Për pasojë, sistemi nuk mbështetet aktualisht nga një marrëveshje në fuqi që të përcaktojë detyrimet e palëve për mirëmbajtjen, mbështetjen teknike, përditësimet, kohën e reagimit ndaj incidenteve dhe garantimin e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit.

Identifikimi dhe adresimi i risqeve në TIK

Monitorimi dhe kontrolli i riskut përbëjnë një proces të vazhdueshëm, i cili synon identifikimin, analizimin, vlerësimin dhe monitorimin e rreziqeve, si dhe evidentimin e rreziqeve të reja që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të institucionit. Ky proces përfshin gjithashtu vlerësimin periodik të efektivitetit të masave të planifikuara për trajtimin e rreziqeve dhe përshtatjen e tyre në përputhje me ndryshimet e mjedisit të kontrollit.
Në fushën e Teknologjisë së Informacionit, menaxhimi i riskut konsiston në zbatimin e një qasjeje sistematike për identifikimin, vlerësimin, trajtimin dhe monitorimin e rreziqeve që lidhen me përdorimin, administrimin dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit, infrastrukturës teknologjike dhe aseteve të TI-së, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së shërbimeve, integritetit, konfidencialitetit dhe disponueshmërisë së informacionit.
Nga auditimi u konstatua se Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë nuk disponon Regjistër Risku, në të cilin të identifikohen, dokumentohen, vlerësohen dhe monitorohen risqet që lidhen me veprimtarinë e institucionit, përfshirë edhe risqet e Teknologjisë së Informacionit. Gjatë periudhës së audituar nuk rezultoi të jetë hartuar apo administruar ndonjë dokumentacion që evidenton identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e risqeve, duke mos mundësuar një proces të strukturuar të menaxhimit të tyre.

Kjo situatë është në kundërshtim me nenin 11, pika 2, dhe nenin 12, pika 3, shkronja "d", si dhe nenet 19–21 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, të cilat ngarkojnë drejtuesit dhe menaxherët e njësive publike me detyrimin për identifikimin, krijimin dhe administrimin e Regjistrit të Riskut, si dhe për vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që mund të cenojnë arritjen e objektivave institucionale. Gjithashtu, kjo nuk është në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 21, datë 25.10.2016, "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve", si dhe Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike".

Faqja zyrtare web(https://qttbfushekruje.gov.al/)

Gjatë testimit të funksionaliteteve të faqes zyrtare të internetit u konstatuan mangësi në funksionimin e elementeve të navigimit, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aksesueshmërinë dhe përdorshmërinë e informacionit të publikuar. Konkretisht, u evidentua se menuja kryesore e navigimit nuk funksionon në mënyrë të plotë, pasi gjatë pozicionimit të kursorit mbi kategoritë kryesore nuk shfaqen dhe nuk aktivizohen nënmenutë përkatëse (dropdown menus). Për rrjedhojë, përdoruesit nuk mund të aksesojnë të gjitha seksionet dhe nënseksionet e faqes përmes strukturës së navigimit, duke kufizuar përdorimin normal të saj dhe aksesin në informacionin institucional.

Ky konstatim tregon mungesë të monitorimit dhe testimit periodik të funksionalitetit të faqes së internetit pas publikimit të saj, si dhe mangësi në procesin e mirëmbajtjes teknike. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 18.12.2024, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike", i cili kërkon që faqet zyrtare të jenë plotësisht funksionale, të aksesueshme dhe të mirëmbajtura në mënyrë të vazhdueshme.

Nga pikëpamja teknike, mosfunksionimi i menusë mund të lidhet me konfigurime të pasakta të skripteve (JavaScript, probleme në stilimin CSS) papajtueshmëri ndërmjet komponentëve të aplikacionit ose mungesë të mirëmbajtjes periodike të platformës. Si pasojë, ulet cilësia e shërbimeve elektronike të ofruara, vështirësohet navigimi në faqe dhe cenohet përvoja e përdoruesve gjatë aksesimit të informacionit publik.

Gjithashtu, gjatë verifikimit të seksionit "Programi i Transparencës", u konstatua se përmbajtja e publikuar nuk përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi. Linku përkatës **(**/transparenc.html) nuk përmban Programin e Transparencës të institucionit, por informacion që nuk lidhet me përmbajtjen e këtij seksioni. Në këtë rubrikë mungojnë informacionet që duhet të publikohen në mënyrë proaktive, si struktura organizative, funksionet dhe kompetencat e institucionit, aktet administrative, programet dhe dokumentet strategjike, të dhënat mbi buxhetin, prokurimet publike, raportet e veprimtarisë, procedurat për ofrimin e shërbimeve, regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe informacione të tjera që garantojnë transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut.

Mungesa e këtij informacioni kufizon të drejtën e qytetarëve për t'u informuar, ul nivelin e transparencës institucionale dhe nuk garanton publikimin proaktiv të informacionit sipas standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Kjo situatë nuk është në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit", i cili detyron autoritetet publike të hartojnë, publikojnë dhe përditësojnë Programin e Transparencës në faqen e tyre zyrtare të internetit, duke siguruar informacion të plotë, të saktë, të përditësuar dhe lehtësisht të aksesueshëm për publikun.

Nga auditimi u konstatua se faqja zyrtare e internetit nuk plotëson plotësisht kërkesat ligjore dhe teknike për funksionalitetin dhe transparencën institucionale. Konkretisht, menuja kryesore e navigimit nuk funksionon në mënyrë të plotë, pasi nënmenutë (dropdown menus) nuk shfaqen dhe nuk mundësojnë aksesimin e të gjitha seksioneve të faqes. Gjithashtu, seksioni **"Programi**

i Transparencës" nuk përmban informacionin e detyrueshëm që autoriteti publik duhet të publikojë në mënyrë proaktive, duke mos garantuar informimin e plotë të publikut.
Këto mangësi tregojnë mungesë të monitorimit dhe mirëmbajtjes periodike të faqes zyrtare dhe përbëjnë mospërputhje me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 18.12.2024, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike", si dhe me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, "Për të drejtën e informimit", i cili detyron autoritetet publike të sigurojnë funksionalitetin e faqes zyrtare dhe publikimin e plotë, të saktë dhe të përditësuar të Programit të Transparencës dhe informacionit institucional.

2.2Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

Mbi auditimin e ushtruar në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë Krujë në bazë të Programit të Auditimit nr. 624/1, datë 10.06.2026, mbajtur në datë 08.07.2026.
Në zbatim të pikës nr.2 të Programit të Auditimit: "Auditimi i sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave"
Objekti i këtij drejtimi auditimi është:
Verifikimi i mjedisit të sigurisë së informacionit, vlerësimi i politikave të sigurisë, organizimi i sigurisë së TI, Siguria fizike e infrastrukturës TIK dhe saktësia e funksionaliteteve që lidhen me procese të automatizuara.
Në zbatim të programit të auditimit të sipërcituar, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:
- Rregullore mbi Parimet dhe Rregullat e Përgjithshme të Sigurisë së Informacionit
- Procedura e Manaxhimit të Aksesit;
- Manualet e përdorimit të sistemit;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjësit;
- Etj.


Auditimi i Sigurisë së Informacionit është një proces sistematik vlerësimi, i cili synon të analizojë nivelin e mbrojtjes së informacionit dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit në një institucion, me qëllim identifikimin e dobësive, rreziqeve dhe incidenteve të mundshme që mund të cenojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave. Ky proces i mundëson institucionit të vlerësojë efektivitetin e kontrolleve të sigurisë, të sigurojë përputhshmërinë me kërkesat ligjore, aktet nënligjore dhe standardet e sigurisë së informacionit, si dhe të forcojë kulturën e sigurisë dhe ndërgjegjësimin e punonjësve mbi përgjegjësitë dhe rreziqet që lidhen me administrimin e informacionit.

Sistemit Web-GIS

Sistemi i audituar është platforma "Web-GIS për menaxhimin, administrimin dhe publikimin e të dhënave të tokës bujqësore", e zhvilluar për nevojat e Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë. Krijimi i kësaj platforme ka ardhur si rezultat i nevojës për centralizimin dhe përmirësimin e aksesit në informacionin e grumbulluar ndër vite gjatë studimeve të tokës. Përpara implementimit të sistemit, të dhënat mbi karakteristikat, cilësinë dhe përdorimin e tokës ruheshin në kompjuterë individualë dhe në formate të ndryshme dixhitale, duke krijuar vështirësi në administrimin, shkëmbimin dhe përdorimin e tyre nga fermerët, specialistët e bujqësisë, kompanitë dhe shoqatat që operojnë në këtë sektor. Gjithashtu, aksesi në këto të dhëna kërkonte përdorimin e programeve të specializuara GIS, duke kufizuar përdorimin e informacionit nga grupet e interesit që nuk dispononinë këto mjete teknike.
Për adresimin e kësaj problematike është krijuar platforma Web-GIS, e cila synon të sigurojë një mjedis të centralizuar për ruajtjen, administrimin dhe publikimin online të të dhënave të tokës bujqësore. Nëpërmjet kësaj platforme, informacioni gjeohapësinor është bërë më i

aksesueshëm për specialistët, institucionet dhe grupet e interesit, pa qenë e nevojshme instalimi i programeve specifike GIS. Sistemi mundëson vizualizimin dhe analizimin e të dhënave përmes një ndërfaqeje web, duke mbështetur proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes në sektorin bujqësor.


Fig nr.1 Modul në WebGis



Burimi: QTTB

Platforma u mundëson specialistëve të ekstensionit bujqësor të përdorin informacionin mbi karakteristikat dhe cilësitë e tokës për orientimin e fermerëve dhe subjekteve bujqësore në përzgjedhjen e kulturave më të përshtatshme për sipërfaqe të ndryshme. Kjo kontribuon në reduktimin e vendimmarrjeve të bazuara në mungesë informacioni dhe në përmirësimin e eficiencës së përdorimit të tokës. Gjithashtu, të dhënat e administruara në sistem mund të përdoren nga bashkitë dhe institucionet përgjegjëse për përditësimin dhe analizimin e informacionit mbi përdorimin e tokës, skemat ujitëse dhe kulluese, si dhe për vlerësimin e nevojave për ujë në zona të caktuara. Informacioni mbi rrezikun potencial dhe aktual të erozionit mundëson identifikimin e zonave me risk më të lartë dhe mbështet marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e tokës, përfshirë menaxhimin e ujërave sipërfaqësore, mbjelljen e sipërfaqeve pyjore, ndërtimin e brezareve dhe aplikimin e metodave të përshtatshme të ujitjes.
Sistemi është ndërtuar mbi teknologjinë "ESRI", duke përdorur komponentët "Portal for ArcGIS" dhe "ArcGIS Enterprise", të cilët mundësojnë administrimin e përdoruesve, menaxhimin e roleve, publikimin e shërbimeve hartografike dhe ndërveprimin me të dhënat gjeografike dhe tabelare. Platforma është lançuar në vitin 2023 dhe, që nga krijimi i saj, nuk ka pësuar ndryshime të rëndësishme në arkitekturë apo funksionalitete.
Nga pikëpamja e aksesit dhe sigurisë së informacionit, sistemi është organizuar në dy mjedise kryesore me nivele të ndryshme privilegjesh. Mjedisi i parë është "moduli i informimit publik", i cili është i aksesueshëm në internet pa kërkesë për autentifikim. Ky modul u mundëson qytetarëve dhe fermerëve konsultimin e informacionit të publikuar përmes hartave interaktive, navigimin në hartë, kryerjen e matjeve dhe aplikimin e filtrave mbi të dhënat. Funksionalitetet e këtij moduli janë të kufizuara vetëm në nivel leximi ("read-only"), duke mos lejuar ndryshimin, shtimin apo fshirjen e informacionit dhe duke garantuar mbrojtjen e integritetit të të dhënave.

Fig nr.2 Modul në WebGis



Burimi: QTTB

Mjedisi i dytë është "moduli i bashkëpunimit", i cili përbën një hapësirë të kontrolluar dhe të aksesueshme vetëm nga përdorues të autorizuar nëpërmjet kredencialeve të administruara nga përgjegjësi i sistemit. Në këtë mjedis, përdoruesit me privilegje të përcaktuara mund të realizojnë operacione mbi të dhënat gjeografike dhe tabelare, duke përfshirë krijimin, përditësimin dhe fshirjen e informacionit të ruajtur në gjeodatabazën e QTTB-së.

Duke qenë se sistemi përdor një mjedis "Multi-user Geodatabase", administrimi i platformës dhe operacionet që ndikojnë në të dhënat kritike kërkojnë kontrolle të përshtatshme sigurie. Akseset administrative dhe funksionet e menaxhimit të të dhënave nuk realizohen në mënyrë të hapur nga interneti, por nëpërmjet një lidhjeje të sigurt VPN, duke kufizuar ekspozimin e shërbimeve kritike dhe duke reduktuar rrezikun e aksesit të paautorizuar.

Gjatë auditimit u vlerësuan gjithashtu elementët që lidhen me mbrojtjen e informacionit, menaxhimin e përdoruesve dhe gjurmueshmërinë e veprimeve në sistem. Dokumentacioni teknik dhe manualet e përdorimit të platformës, të cilat mbajnë klasifikimin ""Konfidenciale"", mund të përmbajnë informacion teknik mbi konfigurimet e sistemit, adresat e rrjetit, URL të shërbimeve apo të dhëna administrative. Për këtë arsye, ruajtja dhe shpërndarja e këtij dokumentacioni duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar, me qëllim shmangien e ekspozimit të informacionit që mund të ndikojë në sigurinë e infrastrukturës.

Një aspekt i rëndësishëm i kontrollit lidhet me garantimin e integritetit të të dhënave dhe ekzistencën e mekanizmave të gjurmimit ("audit trail"). Duke marrë në konsideratë që përdoruesit e modulit të bashkëpunimit mund të ndryshojnë drejtpërdrejt të dhënat e tokës bujqësore, është e nevojshme që sistemi të mundësojë regjistrimin e veprimeve të kryera, përfshirë identifikimin e përdoruesit, kohën e ndërhyrjes dhe natyrën e ndryshimeve të realizuara. Këto mekanizma janë të domosdoshëm për evidentimin e veprimeve të paautorizuara dhe për ruajtjen e besueshmërisë së informacionit.

Menaxhimi i llogarive të përdoruesve përbën një element thelbësor të kontrollit të aksesit. Proceset për krijimin e llogarive, përcaktimin e roleve, rishikimin periodik të privilegjeve dhe çaktivizimin e përdoruesve që nuk kanë më nevojë funksionale për akses duhet të jenë të formalizuara, me qëllim parandalimin e përdorimit të kredencialeve nga persona të paautorizuar.

Nga vlerësimi i përdorimit të platformës rezultoi se një nga sfidat kryesore lidhet me nivelin e përdorimit nga publiku dhe grupet e interesit. Megjithëse QTTB Fushë-Krujë ka zhvilluar aktivitete promovuese dhe trajnime me specialistë të Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB) dhe QTTB-të e tjera në nivel kombëtar, numri i përdoruesve dhe frekuenca e konsultimit të sistemit mbeten më të ulëta krahasuar me pritshmëritë fillestare. Kjo situatë

lidhet kryesisht me njohjen ende të kufizuar të platformës nga publiku i gjerë dhe me faktin se përdorimi i informacionit gjeohapësinor në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes në sektorin bujqësor është ende në zhvillim.
Për rritjen e përdorimit të platformës, QTTB Fushë-Krujë ka vijuar organizimin e trajnimeve, ofrimin e asistencës teknike për përdoruesit dhe promovimin e sistemit pranë institucioneve dhe grupeve të interesit. Njëkohësisht, procesi i përditësimit të të dhënave paraqet sfida, pasi administrimi i platformës kërkon njohuri të specializuara teknike në fushën e GIS dhe teknologjisë së informacionit, ndërkohë që përdoruesit kryesorë të sistemit janë specialistë të fushës së bujqësisë. Për më tepër, një pjesë e konsiderueshme e të dhënave historike është krijuar ndër vite në formate dhe struktura të ndryshme, duke kërkuar procese shtesë për harmonizimin, kontrollin dhe integrimin e tyre në sistem.
Sistemi Web-GIS i QTTB Fushë-Krujë përbën një instrument të rëndësishëm për administrimin dhe publikimin e informacionit mbi tokën bujqësore, duke mundësuar akses më të lehtë në të dhëna dhe duke mbështetur institucionet dhe grupet e interesit në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes. Megjithatë, për garantimin e qëndrueshmërisë dhe rritjen e efektivitetit të sistemit, është e nevojshme vijimi i përmirësimit të kontrolleve të sigurisë, formalizimi i proceseve të administrimit të përdoruesve, forcimi i mekanizmave të gjurmimit dhe sigurimi i një procesi të qëndrueshëm për mirëmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave.

Verifikimi i shkallës së sigurisë fizike dhe aksesit në rrjet.

Verifikimi i shkallës së sigurisë së dhomës së serverave me qëllim parandalimin e humbjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv. Auditimi mbi shkallën e sigurisë së dhomës së serverave u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001.
Nga auditimi i infrastrukturës fizike u konstatua se dhoma e serverëve nuk plotëson kushte optimale për funksionimin dhe mbrojtjen e pajisjeve kritike të teknologjisë së informacionit. Kushtet ekzistuese nuk garantojnë një mjedis të përshtatshëm për ruajtjen e vazhdimësisë së shërbimeve dhe mbrojtjen e pajisjeve nga faktorët fizikë dhe mjedisorë, duke rritur rrezikun e dëmtimit të infrastrukturës dhe ndërprerjes së funksionimit të sistemeve.

Administrimi i aseteve të Teknologjisë së Informacionit

Nga auditimi i administrimit të aseteve të Teknologjisë së Informacionit në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë u konstatua se institucioni nuk administron në mënyrë efektive ciklin jetësor të pajisjeve IT. Inventari aktiv përmban ende një numër të konsiderueshëm pajisjesh kompjuterike dhe periferike me vjetërsi të madhe, të blera ose të marra në përdorim gjatë periudhës 1998–2005, përfshirë kompjuterë, printera dhe një ploter. Gjatë auditimit nuk rezultoi të jetë kryer një vlerësim periodik i gjendjes teknike të këtyre pajisjeve, nuk ekziston një klasifikim sipas statusit funksional të tyre dhe mungojnë procedurat e dokumentuara për menaxhimin e ciklit jetësor, si dhe një plan për zëvendësimin ose nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit. Si rrjedhojë, institucioni ekspozohet ndaj rreziqeve që lidhen me përdorimin e pajisjeve të amortizuara, rritjen e kostove të mirëmbajtjes, uljen e performancës së infrastrukturës dhe shtimin e vulnerabiliteteve të sigurisë.

Administrimi dhe përditësimi i të dhënave në sistemin WebGIS

Nga auditimi u konstatua se procesi i përditësimit periodik të të dhënave në sistemin WebGIS nuk realizohet në mënyrë efektive, pavarësisht se sistemi është funksional dhe i disponueshëm për përdorim. Specialistët e QTTB Fushë-Krujë hasin vështirësi në ngarkimin dhe përditësimin e informacionit, pasi administrimi i platformës kërkon njohuri të specializuara në fushën e teknologjisë së informacionit, ndërkohë që përdoruesit kryesorë janë specialistë të fushës së bujqësisë. Si pasojë, sistemi nuk shfrytëzohet në potencialin e tij të plotë dhe deri në momentin e auditimit ishin populluar me të dhëna vetëm 8 nga 61 bashki, duke kufizuar plotësinë, aktualitetin dhe besueshmërinë e informacionit të administruar në platformë.

Siguria e platformës WebGIS

Nga auditimi u konstatua se sistemi WebGIS funksionon mbi një version të ArcGIS Enterprise (10.8.x ose 10.9.x), i identifikuar nga dokumentacioni publik i SDK-së (Copyright © 1995–2021 Esri), i cili ka arritur ose ndodhet pranë përfundimit të ciklit të mbështetjes nga prodhuesi. Përdorimi i një versioni me mbështetje të kufizuar rrit ekspozimin ndaj vulnerabiliteteve të njohura të sigurisë, mungesës së përditësimeve dhe korrigjimeve të defekteve, duke ndikuar negativisht në nivelin e sigurisë së platformës.

Dokumentacioni teknik i ArcGIS Server SDK (`/server/sdk/rest/`) është i aksesueshëm publikisht nga interneti dhe rezulton i indeksuar nga motorët e kërkimit pa kërkuar autentikim. Edhe pse nuk përmban të dhëna të institucionit, ekspozimi i këtij informacioni teknik mund të lehtësojë identifikimin e teknologjive të përdorura dhe analizimin e karakteristikave të platformës nga aktorë të paautorizuar, duke rritur mundësinë e shfrytëzimit të vulnerabiliteteve të njohura.

Certifikata SSL/TLS e shërbimit informacioneipertoken.qttbfushekruje.gov.al ka skaduar më datë 13.05.2026. Si rezultat, në momentin e auditimit shërbimi funksiononte me një certifikatë të pavlefshme, duke mos garantuar vlefshmërinë e komunikimit të sigurt.

Nga auditimi u konstatua se Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë nuk disponon procedura të dokumentuara për administrimin e incidenteve dhe problemeve të Teknologjisë së Informacionit, si dhe nuk ka hartuar një plan masash për identifikimin, raportimin, trajtimin dhe monitorimin e incidenteve që mund të ndikojnë në funksionimin e infrastrukturës IT dhe sistemit WebGIS. Për periudhën e audituar, në mungesë të procedurave të shkruara dhe të një specialisti të dedikuar të Teknologjisë së Informacionit, problematikat teknike janë trajtuar në mënyrë rastësore, bazuar në komunikime verbale ose në bashkëpunim me operatorin ekonomik që ka zhvilluar sistemin, pa u administruar regjistra të incidenteve, dokumentim të veprimeve të ndërmarra apo analiza mbi shkaqet dhe masat parandaluese. Kjo situatë nuk garanton një proces të standardizuar për menaxhimin e incidenteve dhe rrit rrezikun e vonesave në rikuperimin e shërbimeve, përsëritjes së problemeve dhe cenimit të disponueshmërisë dhe integritetit të sistemeve të informacionit.

Menaxhimi i mediave fizike të ruajtjes së informacionit

Nga auditimi u konstatua se QTTB Fushë-Krujë ruan informacion elektronik në media të ndryshme fizike, si CD, pajisje USB (flash drive) dhe pajisje hardware, por nuk disponon politika apo procedura të dokumentuara për administrimin, përdorimin dhe mbrojtjen e tyre. Institucioni nuk ka përcaktuar kontrolle për menaxhimin e këtyre mediave, duke përfshirë kërkesat për, kufizimin dhe autorizimin e aksesit, monitorimin e transferimit të informacionit, inventarizimin e mediave, si dhe procedurat për asgjësimin e sigurt të tyre në fund të ciklit të përdorimit. Mungesa e këtyre kontrolleve rrit rrezikun e humbjes, dëmtimit, kopjimit ose zbulimit të paautorizuar të informacionit.

Për sa është trajtuar në këtë Raportit Përfundimtar Auditimi, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi Projekt Raportin.

IV. REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Fushë-Krujë nuk ka në strukturën organizative specialist të Teknologjisë së Informacionit, megjithëse administron infrastrukturë IT, rrjet kompjuterik, faqen zyrtare të internetit dhe sistemin WebGIS. Për shkak të mungesës së një strukture ose specialisti të dedikuar të TI-së, institucioni nuk disponon kapacitetet e nevojshme profesionale për administrimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë së informacionit, duke u mbështetur kryesisht në njohuritë bazë të punonjësve për menaxhimin e aseteve TIK. Kjo situatë rrit rrezikun e gabimeve njerëzore, konfigurimeve të pasakta, vonesave në trajtimin e incidenteve dhe cenon sigurinë, integritetin, disponueshmërinë dhe funksionimin efektiv të sistemeve të informacionit. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 15 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar, i cili kërkon sigurimin e burimeve të nevojshme për funksionimin efektiv të kontrollit të brendshëm, si dhe me standardin ISO/IEC 27001:2022, pika 5.3 "Organizational roles, responsibilities and authorities", që kërkon përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive për sigurinë e informacionit.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
1.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, të marrë masa për sigurimin e kapaciteteve profesionale të nevojshme në fushën e Teknologjisë së Informacionit, nëpërmjet plotësimit të strukturës me specialist të TI-së, me qëllim garantimin e administrimit, mirëmbajtjes dhe monitorimit efektiv të infrastrukturës IT dhe sistemit WebGIS.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se institucioni nuk ka hartuar një plan trajnimi për përdoruesit dhe administratorët e sistemit WebGIS dhe nuk disponon evidenca mbi zhvillimin e trajnimeve, duke mos garantuar aftësitë e nevojshme të personelit për administrimin dhe përdorimin efektiv të sistemi, në kundërshtim me kërkesat e ISSAI 5310.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
2.1 Rekomandimi Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të hartojë dhe zbatojë një plan periodik trajnimi për administratorët dhe përdoruesit e sistemit WebGIS, duke dokumentuar pjesëmarrjen dhe rezultatet e trajnimeve.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se QTTB Fushë-Krujë nuk administron një proces të dokumentuar për identifikimin, vlerësimin dhe monitorimin e risqeve të Teknologjisë së Informacionit, sipas kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar dhe standardeve ISO/IEC 27001:2022.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
3.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të hartojë dhe administrojë Regjistrin e Riskut për Teknologjinë e Informacionit, duke identifikuar, vlerësuar, monitoruar dhe trajtuar risqet që lidhen me sistemet e informacionit dhe infrastrukturën IT.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se administratori i sistemit WebGIS nuk është emëruar me akt administrativ dhe mungojnë rregulloret ose procedurat e dokumentuara për

administrimin e sistemit, duke bërë që administrimi të mbështetet në praktika individuale, në mospërputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, pika 5.2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
4.1 Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të emërojë administratorin e sistemit WebGIS me akt administrativ dhe të hartojë e miratojë rregullore dhe procedura për administrimin e sistemit, ku të përcaktohen qartë përgjegjësitë, kontrolli i aksesit, administrimi i përdoruesve, monitorimi dhe mirëmbajtja e sistemit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se kontrata për mirëmbajtjen dhe mbështetjen teknike të sistemit WebGIS ka përfunduar dhe nuk është rinovuar. Mungesa e mbështetjes teknike për një periudhë të zgjatur ka krijuar rrezik për ndërprerjen e vazhdimësisë së funksionimit të sistemit, cenimin e integritetit të të dhënave dhe mosrealizimin e objektivave për të cilat sistemi Web Gis është financuar duke mos respektuar kërkesat e VKM nr. 710, datë 21.08.2013 "*Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
5.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, të marrë masa për sigurimin e mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknike të sistemit WebGIS, duke lidhur një marrëveshje që garanton mirëmbajtjen, përditësimet, mbështetjen teknike dhe vazhdimësinë e funksionimit të sistemit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se faqja zyrtare e internetit e QTTB Fushë-Krujë paraqet mangësi funksionale, pasi menuja kryesore dhe nënmenutë nuk funksionojnë, duke kufizuar aksesin e përdoruesve në informacionin institucional. Kjo situatë nuk është në përputhje me kërkesat e VKM nr. 782, datë 18.12.2024, "*Për përcaktimin e rregullave të detajuara për aksesimin e faqeve zyrtare të internetit të autoriteteve publike*".
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
6.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të marrë masa për mangësitë funksionale të faqes zyrtare të internetit, duke siguruar funksionimin korrekt të menusë dhe të të gjitha seksioneve të saj.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se seksioni "Programi i Transparencës" në faqen zyrtare nuk përmban informacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi, duke mos garantuar transparencën institucionale dhe të drejtën e publikut për informim. Kjo situatë nuk është në përputhje me Ligjin nr. 119/2014 "*Për të drejtën e informimit*", i ndryshuar, si dhe Programin e Transparencës të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 08-12 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
7.1 Rekomandimi Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të plotësojë seksionin "Programi i Transparencës" në faqen zyrtare të internetit, për të rritur transparencën dhe të drejtën e informimit.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin Web Gis certifikata SSL/TLS e shërbimit informacione për tokën, ka skaduar, duke mos garantuar më përdorimin e një kanali të sigurt komunikimi ndërmjet përdoruesve dhe shërbimit elektronik. Skadimi i certifikatës rrit rrezikun e ekspozimit të komunikimeve ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara dhe cenimit të konfidencialitetit dhe integritetit të informacionit gjatë transmetimit, në mospërputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, kontrolli 8.24.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
8.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të marrë masa për rinovimin në kohë të certifikatës SSL/TLS dhe të monitorojë vazhdimisht vlefshmërinë e certifikatave dixhitale të shërbimeve elektronike.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se dhoma e serverëve nuk plotëson kushtet optimale për funksionimin dhe mbrojtjen e pajisjeve kritike të teknologjisë së informacionit, duke rritur rrezikun e dëmtimit të infrastrukturës dhe ndërprerjes së shërbimeve në mospërputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, kontrolli 7.1.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
9.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të përmirësojë kushtet minimale fizike të dhomës së serverëve, duke siguruar mbrojtjen fizike të pajisjeve dhe zbatimin e praktikave të mira për administrimin e infrastrukturës IT.

Në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se QTTB Fushë-Krujë nuk menaxhon në mënyrë efektive asetet e Teknologjisë së Informacionit, pasi 50% e pajisjeve të TI-së rezultojnë të amortizuara dhe kanë tejkaluar afatin e përcaktuar të përdorimit, ndërkohë që mungojnë procedurat e dokumentuara për vlerësimin, zëvendësimin dhe nxjerrjen e tyre jashtë përdorimit. Kjo situatë rrit riskun e përdorimit të pajisjeve të amortizuara dhe ndikon në sigurinë dhe funksionalitetin e infrastrukturës së TI-së. Situata e konstatuar nuk është në përputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, kontrolli 5.9, si dhe me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik*", i ndryshuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
10.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të hartojë dhe zbatojë procedura për vlerësimin periodik, zëvendësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të pajisjeve IT të amortizuara, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të aseteve të Teknologjisë së Informacionit.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se procesi i përditësimit dhe administrimit periodik të të dhënave në sistemin WebGIS nuk realizohet, pasi deri në momentin e auditimit ishin plotësuar me të dhëna vetëm 8 nga 61 bashki. Mungesa e një procesi të strukturuar për mbledhjen, verifikimin dhe përditësimin e informacionit ndikon në plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të administruara nga sistemi, duke kufizuar përdorimin efektiv të tij për qëllimet institucionale, në mospërputhje me kërkesat e standardit ISSAI 5310.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
11.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të marrë masa për përditësimin periodik dhe të plotë të të dhënave në sistemin WebGIS, duke përcaktuar përgjegjësitë e strukturave përkatëse dhe duke siguruar popullimin e sistemit me të dhëna për të gjitha bashkitë.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se platforma WebGIS funksionon mbi një version të ArcGIS Enterprise, për të cilin ka përfunduar cikli i mbështetjes nga prodhuesi, duke rritur ekspozimin ndaj vulnerabiliteteve të sigurisë dhe duke mos garantuar përputhshmëri të plotë me praktikat e rekomanduara të menaxhimit të sigurisë së informacionit, në referencë me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022, kontrolli 8.8.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
12.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë pas lidhjes së kontratës së mirëmbajtjes për platformën ArcGIS Enterprise, të realizojë përditësimin e

platformës në një version të mbështetur nga prodhuesi, si dhe të sigurojë aplikimin periodik të përditësimeve të sigurisë.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se dokumentacioni teknik i ArcGIS Server SDK është i aksesueshëm publikisht nga interneti dhe i indeksuar nga motorët e kërkimit pa autentikim, duke lehtësuar identifikimin e teknologjive të përdorura dhe rritur ekspozimin ndaj sulmeve. Kjo situatë nuk është në përputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, kontrolli 8.2.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
13.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të kufizojë aksesin publik në komponentët teknikë të ArcGIS Server SDK dhe të konfigurojë sistemin në mënyrë që dokumentacioni dhe shërbimet administrative të mos jenë të aksesueshme nga interneti.

Në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se QTTB Fushë-Krujë nuk disponon procedura të dokumentuara dhe regjistra për menaxhimin e incidenteve të TI-së, si dhe politika për kontrollin e mediave fizike të ruajtjes së të dhënave (CD, USB, hardware). Mungesa e këtyre mekanizmave rrit rrezikun e vonesave në rikuperimin e shërbimeve, si dhe të humbjes, dëmtimit apo zbulimit të paautorizuar të informacionit, duke cenuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e tij. Kjo situatë nuk është në përputhje me standardin ISO/IEC 27001:2022, kontrollet 5.24–5.27.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 12-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
14.1 Rekomandimi: Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore Fushë-Krujë të hartojë dhe zbatojë procedura të dokumentuara për menaxhimin e incidenteve të Teknologjisë së Informacionit dhe për administrimin e mediave fizike të ruajtjes së të dhënave, duke krijuar regjistrin e incidenteve IT dhe duke përcaktuar rregulla për përdorimin, ruajtjen e sigurt të mediave të ruajtjes së informacionit.

Në vijimësi

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT